

# Newsletter

## Autoriteti i Konkurrencës gjatë muajve Korrik-Shtator 2024 ka marrë 23 vendime:

- **Përqendrime:** 16 vendime;
- **Rekomandim:** 1 vendim;
- **Vendime me gjobë:** 2 vendime;
- **Akte nënligjore:** 2 vendime;
- **Përjashtim nga ndalimi i marrëveshjes:** 1 vendim;
- **Vendime të tjera:** 1 vendim.



### Ndër vendimet më të rëndësishme mund të përmendim:

#### 1 Rekomandim

Dhenia e disa rekomandimeve mbi ndryshimin e nivelit tarifor për ndërmarrjen rajonale Ujësjetllës Kanalizime Pogradec SHA.

Komisioni i Konkurrencës, mori në shqyrtim aplikimin për ndryshimin e nivelit tarifor për ndërmarrjen rajonale Ujësjetllës Kanalizime Pogradec SHA.

Nga shqyrtimi dhe vlerësimi i informacionit mbi aplikimin për ndryshimin e nivelit tarifor si dhe projekt-vendimit përkatës "Mbi miratimin e ndryshimit të tarifave të shërbimit të furnizimit me ujë dhe largimin e ujërave të ndotura për ndërmarrjen rajonale Ujësjetllës Kanalizime Pogradec SHA", Komisioni i Konkurrencës me **vendimin nr. 1094, datë 11.07.2024**, vendosi t'i rekomandojë Entit Rregullator të Ujit si vijon:

1. Tarifat e ndryshuara, që do të miratohen nga ERRU për ndërmarrjen rajonale Ujësjetllës Kanalizime Pogradec SHA, të jenë të orientuara drejt kostos së shërbimeve dhe të jenë të bazuara në parimin e mosdiskriminimit.
2. Miratimi i ndryshimit të tarifave, të marra në shqyrtim nga KKRR, të jetë i publikuar në faqen zyrtare elektronike të ERRU-së.
3. Të bëhen transparente në faqen zyrtare të Bashkisë Pogradec, ndërmarrjen rajonale Ujësjetllës Kanalizime Pogradec SHA seancat e zhvilluara të dëgjësës publike më palët e interesit për propozimin e ndryshimit të tarifave.

2

## Abuzim me pozitën dominuese

Gjobitet në shumën 97,700,736 Lekë ndërmarrja ANTEA CEMENT SHA për shkelje të rëndë të nenit 9, pika 2, germat “a” dhe “c”, të ligjit nr.9121/2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”.

Gjatë vitit 2022, Sekretariati i Autoritetit të Konkurrencës ka monitoruar tregun e prodhimit/importit dhe shitjes me shumicë të çimentos, me qëllim evidentimin nëse ka apo jo shenja të kufizimit, shtrembërimit apo pengimit të konkurrencës në këtë treg. Në vazhdim të procedurës, pas realizmit të inspektimeve dhe analizës së të dhënave u hartua raporti i hetimit të thelluar i cili i'u bë me dije ndërmarrjes Antea Cement SHA.

Nga analiza e çmimeve të shitjes së ndërmarrjes Antea Cement Albania SHA për produktet çimento gri 32.5 R me thasë dhe 42.5 R rifuxho, krahasimi i çmimit mesatar të shitjes me koston mesatare të prodhimit dhe krahasimi i çmimeve mesatare të shitjes së produkteve brenda dhe jashtë vendit rezulton se: ndërmarrja Antea Cement Albania SHA aplikon çmime ekseseve të cilat nuk kanë lidhje të arsyeshme me vlerën ekonomike të produktit, pasi ka diferencë të konsiderueshme midis çmimit mesatar mujor të shitjes sipas tipeve të çimentos dhe koston mesatare mujore të prodhimit të çimentos; në vitin 2020, çmimi mesatar i shitjes së produktit është rritur, megjithëse kosto mesatare e prodhimit të çimentos pëson rënie; çmimi i shitjes së çimentos jashtë vendit është më i ulët se çmimi i shitjes brenda vendit; ndërmarrja Antea Cement SHA ka aplikuar çmim më të ulët për një ndërmarrje kliente të saj në raport me klientët e tjerë, për periudhën nën hetim; ndërkohë për një ndërmarrje tjetër ka vendosur në mënyrë të njëanshme kushte të padrejta dhe të pabarabarta për veprime tregtare të njëjta me klientët e saj duke i vendosur ato në kushte të pafavorshme konkurrence, sjellje e cila bie në kundërshtim me nenin 9, pika 2, germa a) dhe c), të ligjit nr. 9121/2003.

Sa më sipër Komisioni Konkurrencës me **vendimin nr.1091 datë 01.07.2024** vendosi mbylljen e procedurës së hetimit të thelluar në tregun prodhimit dhe shitjes së çimentos gri dhe të bardhë, si dhe:

- Konstatimin e abuzimit me pozitën dominuese të ndërmarrjes ANTEA CEMENT SHA në tregun e prodhimit dhe shitjes me shumicë të çimentos gri.
- Gjobitjen e ndërmarrjes ANTEA CEMENT SHA për shkelje të rëndë të konkurrencës konkretisht të nenit 9, pika 2, germat a) dhe c), të ligjit nr. 9121/2003, në shumën 97,700,736 (nëntëdhjetë e shtatë milion e shtatëqind mijë e shtatëqind e tridhjetë e gjashtë) Lekë.
- Monitorimin e sjelljes së ndërmarrjes Antea Cement SHA, për një periudhë 1 (një) vjeçare nga data e daljes së këtij vendimi.

3

## Përqendrim

Rasti i përqendrimit të propozuar nëpërmjet krijimit të një ndërmarrje të përbashkët me funksione të plota nga shoqëritë Marcegaglia Steel S.P.A. dhe Manni Group S.P.A.

Komisioni i Konkurrencës, mori në shqyrtim rastin e përqendrimit të propozuar nëpërmjet krijimit të një ndërmarrje të përbashkët me funksione të plota nga shoqëritë Marcegaglia Steel S.P.A. dhe Manni Group S.P.A.

Transaksioni i propozuar nuk do të krijojë mbivendosje ose marrëdhënie të rrjedhës së sipërme apo të poshtme midis aktiviteteve të palëve në nivel kombëtar dhe për këto arsye, transaksioni i synuar nuk do të sjellë ndryshim dhe nuk do të ketë ndikim në tregun shqiptar.

Për këto arsye, Komisioni i Konkurrencës, me **vendimin nr. 1109, datë 16.09.2024**, vendosi të autorizojë përqendrimin e propozuar nëpërmjet krijimit të një ndërmarrje të përbashkët me funksione të plota nga shoqëritë Marcegaglia Steel S.P.A. dhe Manni Group S.P.A”.



## Aktivitete



Në datë 18.07.2024, Kuvendi i Shqipërisë zhvilloi seancën plenare ku Kryetari i Komisionit të Konkurrencës Z. Denar Biba, paraqiti raportin e veprimtarisë së Autoritetit të Konkurrencës për vitin 2023.

Në fjalën e tij, Kryetari i Autoritetit të Konkurrencës, z. Biba prezantoi një përmbledhje të raportit vjetor mbi veprimtarinë e Autoritetit të Konkurrencës, duke u ndalur në arritjet më kryesore të vitit 2023, si dhe në zbatimin e rekomandimeve të përcaktuara në Rezolutën e Kuvendit të Republikës së Shqipërisë.

Gjatë fjalës së tij, z. Biba informoi Kuvendin se gjatë vitit 2023, Komisioni i Konkurrencës ka marrë 93 vendime, kryer 15 monitorime dhe realizuar 8 procedura hetimore, në tregjet sensitive dhe me ndikim të drejtpërdrejtë për mirëqenien e konsumatorit. Gjatë vitit 2023, janë intensifikuar marrëdhëniet brenda dhe jashtë vendit me zhvillimin e 5 aktiviteteve: 1 (një) konferencë ndërkombëtare, 1 (një) takim me botën akademike në Tiranë dhe 3 (tre) workshop-e me komunitetin e biznesit. Në kuadër të Planit Kombëtar për Integrimin Evropian 2023 – 2025, Autoriteti i Konkurrencës ka përmbushur 100% këtë plan, duke miratuar brenda afateve kohore të përcaktuara, 3 (tre) aktet nënligjore të parashikuara, në përputhje të plotë me legjislacionin evropian në fushën e konkurrencës.

Kryetari i Autoritetit të Konkurrencës theksoi se, ky institucion do të vijojë të përmbushë qëllimin e tij të përcaktuar në ligjin nr. 9121/2003, për të siguruar një konkurrencë të lirë dhe efektive në treg, përmes monitorimeve, hetimeve dhe marrjen e masave të nevojshme në tregjet sensitive dhe me impakt të drejtpërdrejtë në mirëqenien e konsumatorit shqiptar, do të vazhdojë përafrimin e legjislacionit në kuadër të procesit të integritimit evropian dhe do të mbetet i angazhuar në promovimin e advokacisë së konkurrencës me palët e interesit.

